

03.06-19

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARË NE DORËZIM - PRIMLJENO - RECEIVED			
Nësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	35676	2



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta Ministry of Culture, Youth and Sports	
Ref. Nr.	2133/2019
Data Datum Date	29-05-2019
nënshkrim Potpis Signature	
PRISHTINË, PRISTINA / PRISHTINA	

Republika e Kosovës  
 Republika Kosova-Republic of Kosovo  
 Qeveria -Vlada-Government

## MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

I LIDHUR

NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

DHE

KOMUNES SE SUHAREKËS

## **1. QËLLIMI I MEMORANDUMIT**

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është hartimi dhe zbatimi i projektit “ **Kulla e Familjes Tafollaj** “ ne fshatin Çadrak- Komuna e Suharekës , i cili do të zbatohet gjatë vitit 2019.

## **2. AUTORITETET**

Qëllim i Memorandumi do të përmbushet nga:

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ( MKRS )
- Komuna e Suharekës

## **3. OBLIGIMET E PALËVE**

### **3.1. OBLIGIMET E MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT (më tutje MKRS)**

MKRS merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi, si në vijim:

3.1.Harton projektin dhe inicion procedurën e prokurimit për projektin “ Kulla e Familjes Tafollaj “ ne fshatin Çadrak- Komuna e Suharekës ;

3.2. Financon zbatimin e projektit me mjetet financiare në vlere prej 10,000.00 euro ( Dhjetë mijë euro ), sipas buxhetit të përcaktuar për vitin 2019, Kodi i projektit 15729 ( ne buxhetin e MKRS-së) dhe 10.000 euro ( Dhjetë mije euro )nga programi Masa preventive-intervenime emergjente;

3.3.Emërimin e organeve mbikëqyrëse me sa vijon: Një përfaqësues nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, një nga Instituti i Kosovës për Mbrojtje te Monumenteve ( IKMM) dhe një nga Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore ne Prizren ( QRTK-Prizren).

## **4. Komuna e Suharekës**

Komuna e Suharekës, merr përsipër këto obligime sa i përket qëllimit të këtij Memorandumi, si në vijim:

4.1.Bashkë financon projektin “ Kulla e Familjes Tafollaj “ ne fshatin Çadrak -Komuna e Suharekës

4.2..Obligohet ti përmbahet në përpikëri projektit të hartuar dhe dorëzuar ne MKRS kurse për çdo ndryshim si rezultat i punëve në terren, obligohet të informoj dhe kërkoj miratim për ndryshimet në MKRS/DTK/IKMM;

4.3.Obligohet te caktoj organin mbikëqyrës te projektit; Një kopje te Vendimit për caktimin e organit mbikëqyrës ta dërgoj ne Departamentin e Trashëgimisë Kulturore- si njësi kërkuese;

4.4.Organi mbikëqyrës, duhet te komunikojë dhe bashkërendoj veprimet ne bashkëpunim te ngushte me organet mbikëqyrëse te emëruar nga MKRS sipas pikës 3.3 te këtij memorandum;

## **5. OBLIGIMET E PËRBASHKËTA TË PALEVE**

Palët marrin përsipër këto obligime te përbashkëta sa i përket qëllimit te këtij Memorandumi, si ne vijim:

5.1.Realizimin e projektit dhe përmbushjen e objektivave si është përcaktuar ne Dokumentin e Politikave Programore te Departamentit te Trashëgimisë Kulturore për vitin 2019, buxhetin e MKRS-se dhe buxhetin e Komunës se Suharekës ;

5.2.Bashkepunojne gjate kohës se zbatimit te projektit dhe informojnë njëra tjetrën përmes organeve mbikëqyrëse, te përcaktuara ne këtë memorandum

5.3.Shpenzimin e buxhetit sipas miratimit paraprak dhe te përcaktuar për vitin 2019.

## **6. ZBATIMI**

MKRS dhe institucionet vartëse te saj si dhe Komuna e Suharekës, përcjellin zbatimin e memorandumit dhe udhëzojnë për veprime qe duhet te ndërmerren ne përmbushjen e obligimeve te përcaktuara ne këtë Memorandum.

## **7. MUNDËSIA E NDËRPRERJES SE MEMORANDUMIT DHE RRETHANAT E PA PARASHIKUARA**

7.1.Ndërprerja e Memorandumit të Mirëkuptimit bëhet më marrëveshje ndërmjet palëve;

7.2.Nëse implementimi duhet të ndërpritet për shkak të ndodhive të Fuqisë mbinatyrore – Vis maior dhe rrethanave tjera të pa parashikuara, palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim ne palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren;

7.3.Afati i realizimit te qëllimit te këtij Memorandumi duhet te arrihet gjate vitit 2019.

7.4.Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshoj apo plotësohet sipas një Marrëveshje me shkrim midis palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë MM, për të cilat palët do të pajtohen për të hyrë në MM në të ardhmen, apo në një amendament të këtij MM-je, të nënshkruar nga palët e kësaj Marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë dokument.

## **8. ZGJIDHJA NË RAST TË MOSMARRVESHJEVE**



Palët do të përpiqen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime, mirëpo nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë në rast të mosmarrëveshjes, kompetente për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë që ka kompetencë të zgjidh rastet e tilla.

## 9. KOPJET DHE GJUHËT E MEMORANDUMIT

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përpiluar në katër (4) kopje origjinale. Secila palë do ta ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

## 10. HYRJA NË FUQI

Ky Memorandum Mirëkuptimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

**Kujtim Gashi, Ministër**

**Ministria e Kulturës, Rinisë,  
dhe Sporteve**



29 / 5 / 2019

**Bali Muharremi, Kryetar**

**Komuna e Suharekës**

